

“Uniformë ushtarake, fatrolla për mbajtjen e karikatorëve, jelek antiplumb” – Policia jep detaje se çka u gjet nga aksioni në Zveçan



18/09/2025 12:33

f

t

Policia e Kosovës ka gjetur sërish pajisje ushtarake në komunën e Zveçanit, në një aksion të zhvilluar paraditen e së enjtes.

Rreth orës 09:45, njësia e hetimeve e Stacionit Policor të Zveçanit ka identifikuar një rimorkio të braktisur, brenda së cilës janë gjetur dy thasë që përmbanin pajisje të ndryshme ushtarake dhe municion, raporton [lajmi.net](#)

Sipas njoftimit zyrtar, në vendin e ngjarjes janë konfiskuar:

- 1 uniformë ushtarake kamufluese
- 5 karikatorë me gjithsej 132 fishekë të armës së gjatë AK-47
- 5 fatrolla për mbajtjen e karikatorëve në gjoks
- 4 palë pantallona ushtarake
- 4 xhaketa ushtarake
- 3 fotrolla për radiolidhje
- 1 jelek antiplumb
- 2 rripa brezi ushtarak
- 1 jelek taktik
- 1 çantë taktike
- 1 helmetë e gjelbër
- 1 kapelë
- 1 dritë rrotative

Në vendin e ngjarjes kanë dalë të gjitha njësitë relevante policore, ndërsa prokurori i Shtetit është informuar për të gjitha veprimet e ndërmarra. Me urdhër të tij, është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”.

Deri më tani nuk është arrestuar asnjë person, por dyshohet se pajisjet e gjetura mund t'i përkasin një personi tashmë në kërkim në lidhje me ngjarjen e armatosur të njohur si rasti “Banjska”.[/Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- Çitaku: Qeveria e ardhshme e Kosovës do të jetë pa Lëvizjen Vetëvendosje
- Arifi: Përparim Rama po përpiqet të tregoj se...
- Kajtazi: Ndoshta sheshi “Xhorxh Bush” po bllokohet nga...
- Krasniqi: S'ka konkurrencë – Uran Ismaili është më i madh se PDK-ja

Artikuj të ngjashëm



September 19, 2025

Çitaku: Qeveria e ardhshme e Kosovës do të jetë pa Lëvizjen Vetëvendosje



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

